

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Gusht 2019


**Tiranë, më 24 Shtator 2019:** Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Gusht 2019, janë 2.256.761.

Krahasuar me Gusht 2018, ky tregues rezulton me rritje 6,4 %. Në Gusht 2019, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 1.556.826, krahasuar me Gusht 2018, ky numër është rritur me 7,4 %.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në vendin tonë përgjatë tetë muajve të 2019 është 4.870.588, duke u rritur me 10,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në Gusht 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Maqedonia ka pasur rritjen më të madhe me 19,2 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Polonia me 19,6 %.

Përgjatë tetë muajve të 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Zvicra ka pasur rritjen më të madhe me 16,9 % ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Polonia me 13,3 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Gusht 2019, janë 2.160.387 duke shënuar një ulje me 1,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Gusht 2019, janë 726.068, krahasuar me Gusht 2018, ky numër është rritur 5,4 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Gusht 2019, janë 1.434.319., krahasuar me Gusht 2018, ky numër është ulur 4,1 %.

Numri i shtetasve shqiptarë që kanë dalë nga territori i vendit tonë përgjatë tetë muajve të 2019, është 3.898.681 duke u rritur 9,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Gusht 2018	Gusht 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Gusht 2018	Janar-Gusht 2019	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje Gjithsej</b>	<b>2.120.822</b>	<b>2.256.761</b>	6,4	<b>7.858.989</b>	<b>8.582.641</b>	9,2
Shqiptarë	670.870	699.935	4,3	3.461.350	3.712.053	7,2
Të Huaj	1.449.952	1.556.826	7,4	4.397.639	4.870.588	10,8
<b>Dalje Gjithsej</b>	<b>2.184.720</b>	<b>2.160.387</b>	-1,1	<b>7.989.331</b>	<b>8.444.431</b>	5,7
Shqiptarë	688.559	726.068	5,4	3.550.502	3.898.681	9,8
Të Huaj	<b>1.496.161</b>	<b>1.434.319</b>	-4,1	4.438.829	4.545.750	2,4

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj**

Shtetet	Gusht 2018	Gusht 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Gusht 2018	Janar-Gusht 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	670.375	781.227	16,5	1.600.206	1.838.772	14,9
Maqedoni	124.133	148.025	19,2	484.492	520.469	7,4
Greqi	79.604	89.489	12,4	366.837	401.262	9,4
Itali	118.165	123.051	4,1	323.541	346.758	7,2
Angli	22.536	22.741	0,9	87.745	94.966	8,2
Mali i zi	21.850	24.636	12,8	232.794	240.231	3,2
Poloni	36.518	29.349	-19,6	121.444	105.314	-13,3
SHBA	21.032	18.547	-11,8	87.688	91.065	3,9
Spanjë	6.722	7.364	9,6	18.717	21.024	12,3
Gjermani	26.926	26.896	-0,1	102.254	115.784	13,2
Zvicër	9.934	9.194	-7,4	42.747	49.953	16,9
Të tjera	312.157	276.307	-11,5	929.174	1.044.990	12,5
Gjithsej/Total	1.449.952	1.556.826	7,4	4.397.639	4.870.588	10,8

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Gusht 2018	Gusht 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Gusht 2018	Janar-Gusht 2019	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje Shtetas të Huaj</b>	<b>1.449.952</b>	<b>1.556.826</b>	<b>7,4</b>	<b>4.397.639</b>	<b>4.870.588</b>	<b>10,8</b>
I. Personale	1.443.066	1.548.855	7,3	4.342.132	4.806.051	10,7
1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.	1.417.769	1.523.896	7,5	4.203.103	4.654.398	10,7
2. Trajtim shëndetësor	8	10	25,0	147	478	225,2
3. Qëllime fetare	42	91	116,7	561	622	10,9
4. Udhëtarë transit	25.247	24.858	-1,5	138.321	150.553	8,8
II. Biznes dhe profesionale	6.886	7.971	15,8	55.507	64.537	16,3

**Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Gusht 2018	180.735	204.989	1.735.098	196.883	249.916	1.737.921
Gusht 2019	202.700	204.158	1.849.903	222.327	249.163	1.688.897
Ndryshimi vjetor (%)	12,2	-0,4	6,6	12,9	-0,3	-2,8
Janar-Gusht 2018	1.015.525	585.406	6.258.058	982.585	579.656	6.427.090
Janar-Gusht 2019	1.126.379	621.460	6.834.802	1.093.029	616.601	6.734.801
Ndryshimi vjetor (%)	10,9	6,2	9,2	11,2	6,4	4,8

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

## Përkufizime

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet:** Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

**Vizitor:** Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

*Qëllime personale* të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

*Kategoria e biznesit* që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambientit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

**Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:**

- Ligjit nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", neni 17 "Lehtësimi i verifikimeve Kufitare", ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.